

## HEQJE PËRGJEGJËSIE PËR GJENDJE SHËNDETËSORE

TË DHËNA ANAGRAFIKE (përbushje nga ana e pasagjerit dhe dërgimi pranë GNV-së jo më vonë se 5 ditë pune nga data e nisjes së anijes).

E nderuar **GRANDI NAVI VELOCİ S.p.A.**

I/e nënshkruari/a.....,

lindur më .....në .....

me banim në .....

lloji i dokumentit .....nr.....

deklaron se dëshiron të kryejë një udhëtim mbi anijen M/n ..... nga .....në ..... në datën ..... me biletë numër GN....., duke i hequr çdo lloj përgjegjësie kompanisë lundruese.

**Data dhe firma e pasagjerit**.....

**TË DHËNAT IDENTIFIKUESE të përfaqësuesit ligjor (nëse subjekti nuk ka pjesërisht/plotësisht pavarësinë për të marrë vendime):**

Emri dhe mbiemri .....

Lindur ..... më .....

**DETAJE MJEKËSORE (dokument i përbushur nga mjeku kurues)**

I/e nënshkruari/a..... deklaron se Z/Znj.....në terapi për  patologjinë (saktësoni patologjinë)..... gjendje shtatzënie (saktësoni javën e shtatzënisë dhe sidoqoftë certifikata mjekësore duhet të plotësohet në një periudhë jo më herët se një javë nga data e nisjes) ..... nuk paraqet kundër udhëzime për të udhëtuar me anije.

**Vula dhe firma e mjekut kurues**.....

*(Pjesa më poshtë duhet të përbushet vetëm nëse pasagjeri është në terapi me oksigjen)*

Bombola e oksigjenit mbulon nevojën për oksigjen të Z. .... për të gjithë kohëzgjatjen e udhëtimit. **Vula dhe firma e mjekut kurues**.....

**Oksigjeni.** Oksigjeni lejohet për përdorim personal të pasagjerit, i cili duhet të furnizojë bombolën në mënyrë të pavarur, duke mbuluar edhe shpenzimet e nevojshme. Për të imbarkuar një bombolë oksigjeni, është e nevojshme të bashkëngjitni skedën teknike të modelit të bombolës që keni ndërmend të sillni në bord.

**Grandi Navi Veloci ju kujton se:**

- hipja e barnave dhe/ose pajisjeve që mund të nevojiten gjatë lundrimit është përgjegjësi ekskluzive e pasagjerit.

## HEQJE PËRGJEGJËSIE PËR GJENDJE SHËNDETËSORE

- Kapitani ka të drejtë - sipas mendimit të Oficerit Mjekësor në bord - që të refuzojë, sipas gjykimit të tij, imbarkimin, nëse siguria e pasagjerit mund të jetë në rrezik gjatë udhëtimit.
- Përveç rasteve të parashikuara nga dokumenti informues bashkëlidhur me këtë dokument (Shtojca A), ne ju informojmë se të dhënat personale dhe të veçanta që ju jepni në këtë formular do të trajtohen nga Grandi Navi Veloci në përputhje të plotë me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së mbi mbrojtjen e të dhënave personale n . 679/2016 dhe d. lgs. 196/03 e të mëtejshëm siç parashikohet nga d.lgs.101/18.

I interesuari ka të drejtë të ofrojë ose jo të dhënat e tij personale, sidomos të dhëna në lidhje me shëndetin.<sup>1</sup>, megjithatë mosdhënia e të dhënave mund të bëjë të pamundur marrjen e asaj që kërkohet.

Për më shumë informacion, mund të kontaktoni Titullarin ose Përgjegjës për Mbrojtjen e të Dhënave duke shkruar një e-mail në: [dataprotection@gnv.it](mailto:dataprotection@gnv.it).

- **BASHKËLIDHUR ME:** “DOKUMENTIN INFORMUES MBI TRAJTIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE sipas nenit 13 të Rregullores BE 2016/679 (“Rregullorja” ose “DPPM”) dhe D.lgs. 196/2003, siç përshkruhet nga D.lgs. 101/2018”.

---

<sup>1</sup> Hyjnë në kategori të veçanta të të dhënave personale, në përputhje me nenin 9.1 të DPPM, të dhënat që *“zbulojnë origjinën racore ose etnike, opinionet politike, besimin fetar ose filozofik, ose anëtarësimin në sindikatë, përpunojnë të dhënat gjenetike, të dhënat biometrike të destinuara për të identifikuar në mënyrë unike një person fizik, të dhënat në lidhje me shëndetin e personit ose jetën seksuale ose orientimin seksual.*

# HEQJE PËRGJEGJËSIE PËR GJENDJE SHËNDETËSORE

## DOKUMENT PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE *Sipas nenit 13 të Rregullores BE 2016/679 ("Rregullorja" ose "DPPM") dhe D.lgs. 196/2003, siç përshkruhet nga D.lgs. 101/2018*

### 1. Titullari për trajtimin e të dhënave

Titullari për trajtimin e të dhënave është Grandi Navi Veloci S.p.A., me seli ligjore në Palermo, Calata Marinari d'Italia, kodi fiskal dhe TVSH n.13217910150 (më tej i quajtur "GNV" ose "Titullar").

Titullari mund të kontaktohet duke shkruar në adresën: [direzione@pec.gnv.it](mailto:direzione@pec.gnv.it).

Titullari ka emëruar një Përgjegjës për Mbrojtjen e të dhënave personale (Data Protection Officer - DPO -) i cili mund të kontaktohet për çdo lloj informacioni ose kërkesë në adresën e-mail:

[dataprotection@gnv.it](mailto:dataprotection@gnv.it).

### 2. Lloji i të dhënave

Titullari përpunon, mbledh dhe/ose merr informacionin në lidhje me palën e interesuar (nëse në moshë të mitur, pasi merr autorizimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore), të tilla si: emri, mbiemri, adresa fizike, kombësia, krahina dhe komuna e banimit, detajet e udhëtimit, patologjitë nga të cilat vuan.

### 3. Qëllimin e trajtimit

Titullari ju informon mbi trajtimin e të dhënave tuaja personale dhe të drejtave tuaja.

Të dhënat tuaja personale (nëse personi në fjalë është i mitur, me autorizimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore) mund të përpunohen për qëllimet e mëposhtme:

1 – **për të përmbushur detyrimet ligjore, sipas nenit 6.1.c) DPPM:** domethënë për të përmbushur detyrimet e parashikuara nga ligji, nga një rregullore, nga legjislacioni i komunitetit, si dhe nga dispozitat e lëshuara nga Autoritetet e legjitimuara me ligj ose nga Organet kompetente të mbikëqyrjes ose kontrollit (në këtë rast pëlqimi Juaj nuk është i nevojshëm pasi trajtimi i të dhënave është i lidhur me përmbushjen e këtyre detyrimeve/dispozitave);

2 – **për ekzekutimin e detyrimeve kontraktuale të shitjes dhe asistencës, sipas nenit. 6.1.b) DPPM, dhe, për kategoritë e veçanta të të dhënave personale (p.sh. "gjendja shëndetësore") sipas nenit 9.2.a) DPPM:** domethënë për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontratat në të cilat Ju jeni pjesë ose për të përmbushur, para ose pas përfundimit të kontratës, kërkesat tuaja specifike, edhe nëpërmjet teknikave të komunikimit në distancë, duke përfshirë një call center telefonik posaçërisht për Asistencën ndaj Klientit (në këtë rast pëlqimi Juaj nuk është i nevojshëm, pasi trajtimi i të dhënave është funksional për menaxhimin e marrëdhënies ose për ekzekutimin e kërkesave);

3 – **qëllim mbrojtës:** për të vërtetuar, ushtruar ose mbrojtur një të drejtë në Gjykatë sipas neneve 6.1.f) dhe 9.2.f) DPPM; Dhënia e të dhënave tuaja personale për qëllimet e përmendura në numrat 1, 2 dhe 3 është opsionale, megjithatë në rast mosdhënieje, përmbushja e detyrimeve kontraktuale të shitjes dhe ndihmës nga Titullari nuk do të jetë e mundur.

### 4. Përfituesit e transferimit të të dhënave

Të dhënat personale do të mund t'i komunikohen:

- personelit që do të ketë për detyrë trajtimin e tyre sipas nenit 29 të DPPM dhe në veçanti personelit lundrues;
- subjektet, njësitë ose autoritetet, titullarët e pavarur të të dhënave, të cilëve është e detyrueshme tu komunikoni të dhënat tuaja personale në përputhje me dispozitat ligjore ose urdhrat e autoriteteve (organet mbikëqyrëse, autoritetet gjyqësore, kompanitë e sigurimeve për ofrimin e shërbimeve të sigurimit);
- subjekte që zakonisht veprojnë si përgjegjës të të dhënave në përputhje me nenin 28 të DPPM; lista e përditësuar dhe e plotë mund të kërkohej nga Titullari i të Dhënave në adresat e treguara më lart.

Për sa i përket transferimit të mundshëm të të Dhënave Personale në Vendet e Treta, Shoqëria njofton se trajtimi do të kryhet sipas njëres prej metodave të lejuara nga ligji aktual, siç është p.sh. pëlqimi i palës së interesuar, miratimi i klauzolave standarde

## HEQJE PËRGJEGJËSIE PËR GJENDJE SHËNDETËSORE

të miratuara nga Komisioni Evropian, zgjedhja e subjekteve që i përmbahen programeve ndërkombëtare për qarkullimin e lirë të të Dhënave Personale (p.sh. EU-USA Privacy Shield) ose që operojnë në Vendet që konsiderohen të sigurta nga Komisioni Evropian. Mund të merrni më shumë informacione shtesë duke i bërë kërkesë Titullarit në kontaktet e përmendura më sipër.

### 5. Ruajtja dhe mënyra e trajtimit

Sigurohet që të gjitha trajtimet e të dhënave do të bazohen në parimet e vendosura nga DPPM-ja, duke pasur parasysh në veçanti ligjshmërinë, korrektësinë dhe transparencën e trajtimit, përdorimin e të dhënave për qëllime specifike, të qarta dhe legjitime, në një mënyrë të përshtatshme në lidhje me trajtimin, duke respektuar parimet e minimizimit të të dhënave, saktësinë, kufizimin e ruajtjes, integritetin dhe konfidencialitetin, përgjegjësimin (neni 5 i DPPM-së).

Të dhënat personale përpunohen përmes veprimeve të mëposhtme: grumbullimit, regjistrimit, organizimit, strukturimit, ruajtjes, konsultimit, adaptimit ose modifikimit, përdorimit, shpërndarjes, zbulimit përmes transmetimit, rikuperimit, shtrirjes, kombinimit, kufizimit, fshirjes dhe shkatërrimit të të dhënave. Të dhënat personale i nënshtrohen përpunimit me letër dhe elektronik.

Titullari do të trajtojë të dhënat personale për kohën e nevojshme për të realizuar qëllimet e treguara më sipër.

### 7. Të drejtat e të interesuarit

Në cilësinë e palës së interesuar në përpunimin e të dhënave në fjalë, ju keni të drejtat e mëposhtme njohëse dhe të kontrollit siç parashikohen nga DPPM.

TË DREJTA NJOHËSE	
<p><b>E drejta për dokumentacionin informues neni 13-14</b> duke konsideruar 58, 60</p>	<p>Të interesuarit kanë të drejtë të marrin informacione të sakta mbi trajtimin e të dhënave të tyre personale.</p> <p>Dokumentacioni informues duhet të përmbajë këto informacione:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identitetin e titullarit</li> <li>• Identitetin e oficerit për mbrojtjen e të dhënave - DPO -</li> <li>• Qëllimin e trajtimit</li> <li>• Baza juridike</li> <li>• Interesin e mundshëm ligjor që përbën bazën juridike</li> <li>• Detyrime të mundshme ligjore ose kontraktuale në bazë të të cilave do të jepen</li> <li>• Rrethanat e qarkullimit të të dhënave (BE apo jashtë BE-së)</li> <li>• Kohëzgjatja e trajtimit</li> <li>• Procesin (e mundshëm) vendimor në bazën e trajtimit të automatizuar</li> <li>• Të drejtat e palës së interesuar: aksesit, korrigjimit, integrimi i anulimit, kufizimi i opozitës, transportueshmëria, ankesa ndaj një Autoriteti Garantues, revokimi i pëlqimit</li> </ul>
<p><b>E drejta për akses neni 15</b> duke konsideruar 63</p>	<p>Pala e interesuar ka të drejtë të marrë nga titullari për trajtimin e të dhënave konfirmimin nëse është duke u kryer apo jo një trajtim i të dhënave që i përkasin dhe, në këtë rast, do t'i jepet aksesit në të dhënat personale.</p>
TË DREJTAT PËR KONTROLL	
<p><b>E drejta për të anuluar dhe integruar neni. 5 (1) (d), 16</b> duke konsideruar 39, 59, 65, 73</p>	<p>Pala e interesuar ka të drejtë të marrë nga titullari për trajtimin e të dhënave anulimin e të dhënave të pasakta personale në lidhje me të pa vonesa të panevojshme.</p> <p>Duke marrë parasysh qëllimet e trajtimit, pala e interesuar ka të drejtë të përfitojë integrimin e të dhënave personale jo të plota, madje edhe duke dhënë një deklaratë plotësuese.</p>
<p><b>E drejta për fshirjen dhe harresën neni 17</b> duke konsideruar 65-</p>	<p>Pala e interesuar ka të drejtë të marrë nga kontrolluesi i të dhënave fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të pa asnjë vonesë të pajustificuar dhe titullari i të dhënave ka detyrimin të fshijë të dhënat personale pa vonesa të pajustificuara, nëse ekziston një nga arsyet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 17 të Rregullores.</p>

## HEQJE PËRGJEGJËSIE PËR GJENDJE SHËNDETËSORE

66, 68	
<b>E drejta për kufizim neni 18</b> <i>duke konsideruar 67</i>	Subjekti i të dhënave ka të drejtë të marrë kufizimin e trajtimit nga titullari i të dhënave kur ekzistojnë rrethana të caktuara.
<b>E drejta për të kundërshtuar neni 21</b> <i>duke konsideruar 50, 59, 69 -70, 73</i>	Pala e interesuar ka të drejtë të kundërshtojë në çdo kohë, për shkaqe që lidhen me situatën e tij/saj të veçantë, trajtimin e të dhënave personale në lidhje me të, sipas Nenit 6, paragrafi 1, shkronjat e) ose f), duke përfshirë profilizimin në bazë të këtyre dispozitave. Titullari për trajtimin e të dhënave nuk pranon të trajtojë më tej të dhëna personale, me përjashtim të hipotezës se ekzistojnë arsye që e legjitimojnë trajtimin dhe këto arsye mbizotërojnë mbi të drejtën e palës së interesuar për të kundërshtuar.
<b>E drejta për transportueshmërinë neni 20</b> <i>duke konsideruar 68, 73</i>	Bëhet fjalë për një të drejtë të re. Pala e interesuar ka të drejtë të marrë në një format të strukturuar, të përdorur zakonisht si dhe të lexueshëm nga një pajisje automatike, të dhënat personale që i përkasin të cilat duhet t'i sigurohen nga titullari për trajtimin e tyre. Ai gjithashtu ka të drejtë t'ia transmetojë këto të dhëna një titullari tjetër për trajtimin e të dhënave pa pengesa nga titullari i të dhënave që ia ka dhënë ato, nëse: <ul style="list-style-type: none"> <li>përpunimi bazohet mbi pëlqimin në përputhje me nenin 6 paragrafi 1, shkronja a) ose nenin 9, paragrafi 2, shkronja a) ose me një kontratë sipas Nenit 6, paragrafi 1, shkronja b); dhe</li> <li>mbi faktin nëse trajtimi është kryer me mjete të automatizuara.</li> </ul> Një mendim i veçantë u dha mbi për të drejtën e transportueshmërisë nga Grupi Punues WP 29.
<b>E drejta për të kundërshtuar dhe vendimet e bazuara vetëm në përpunimin e të dhënave neni 21 presja 2,3 neni 22</b> <i>duke konsideruar 70</i>	Nëse të dhënat personale trajtohen për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë, subjekti i të dhënave ka të drejtë të kundërshtojë në çdo kohë trajtimin e të dhënave personale që i përkasin atij për këto qëllime, duke përfshirë edhe profilizimin në masën në të cilën është e lidhur me një marketing të tillë të drejtpërdrejtë.
	Subjekti i të dhënave ka të drejtë të mos i nënshtrohet një vendimi të bazuar vetëm mbi trajtimin e automatizuar, duke përfshirë edhe profilizimin, i cili prodhon efekte ligjore që e prekin atë ose që ndikon dukshëm në personin e tij.

Prandaj, si një palë e interesuar, ju keni të drejtat e parashikuara nga artikujt 15 - 22 të DPPM-së, si dhe të drejtën për të parashtruar ankesë tek Autoriteti kompetent sipas nenit. 77 të DPP-së.

### 9. Procedura për ushtrimin e të drejtave dhe komunikimeve

Pala e interesuar mund të dërgojë një kërkesë zyrtare për të ushtruar të drejtat e veta ose një sinjalizim për mosplotësimin ose shkeljen e hamendësua, duke dërguar një e-mail në: [dataprotection@gnv.it](mailto:dataprotection@gnv.it)

Titullari për trajtimin e të dhënave merret me menaxhimin dhe ekzekutimin e kërkesave për ushtrimin e të drejtave në përputhje me DPPM.

Saktësojmë se:

- Afati i fundit për respektimin e kërkesës së palës së interesuar është 30 ditë dhe mund të zgjatet me 60 ditë të tjera, nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh ndërlikimin dhe numrin e kërkesave. Në këtë rast, Titullari informon palën e interesuar për zgjatjen dhe arsyet e vonësës, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.
- Informacioni i dhënë nga pala e interesuar dhe çdo komunikim dhe veprime të ndërmarra janë falas.
- Nëse kërkesat e palës së interesuar janë qartësisht të pabazuara ose të tepruara, veçanërisht për shkak të natyrës së tyre të përsëritshme, titullari për trajtimin e të dhënave mund të:
  - të kërkojë pagesën e një tarife të arsyeshme duke marrë parasysh shpenzimet administrative të bëra për të siguruar informacionin ose komunikimin ose të ndërmarrë veprimet e nevojshme; ose
  - të refuzojë respektimin e kërkesës.

Për çdo sqarim ose kërkesë në lidhje me trajtimin e të dhënave personale, është e mundur të kontaktoni kontrolluesin e të dhënave ose DPO në adresën e e-mailit të treguar më lart në çdo kohë.

*Përditësimi i fundit: tetor 2019*

## HEQJE PËRGJEGJËSIE PËR GJENDJE SHËNDETËSORE

### SHPREHJA DHE MARRJA E PËLQIMIT

#### TË DHËNAT IDENTIFIKUESE të pasaqjerit

Emri dhe mbiemri .....

Lindur ..... më .....

#### TË DHËNAT IDENTIFIKUESE të personit që ushtron të drejtën prindërore dhe/ose të përfaqësuesit ligjor (nëse subjekti nuk ka pjesërisht/plotësisht pavarësinë për të marrë vendime):

Emri dhe mbiemri .....

Lindur ..... më .....

#### **DEKLAROJ**

- se jam informuar në mënyrë të kuptueshme dhe shteruese në lidhje me *kujdesin ekskluziv dhe përgjegjësinë* e imbarkimit të ilaçeve dhe/ose pajisjeve për të cilat mund të kem nevojë gjatë udhëtimit;
- se jam i ndërgjegjshëm për të drejtën që i takon *Kapitenit* - sipas mendimit të Oficerit Mjekësor në bord - *që të refuzojë*, sipas gjykimit të tij, *imbarkimin*, nëse siguria ime mund të jetë në rrezik gjatë udhëtimit;
- se ka marrë *dokumentin informues mbi privatësinë* sipas nenit 13 të Rregullores BE 2016/679 ("Rregullorja" ose "DPPM") dhe D.lgs. 196/2003, siç përshkruhet nga D.lgs. 101/2018 dhe se do të japë pëlqimin e vet për trajtimin e kategorive të veçanta të të dhënave personale sipas nenit 9.2.a) të DPPM.

*Në rast gruaje në moshë pjellore:*

#### **KONFIRMOJ**

se nuk jam shtatzënë

*Vendi dhe data*

Firma e personit të INTERESUAR (ose kujdestarit ligjor)

Ky formular hartohet në KOPJO TË DYFISHTË.

Kopja origjinale e formularit të hartuar dhe nënshkruar duhet të dërgohet nga i interesuari në GNV jo më vonë se 5 ditë pune nga data e nisjes së anijes; kopja tjetër do të mbahet nga vetë i interesuari ose, nëse është e aplikueshme, nga përfaqësuesi i tij i vlefshëm ligjërisht.